

STATUTI

I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"SOLOIL SERVICE ALBANIA " SH. P. K.

Sot me, 26/05/2021, ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Sipermarrijeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e tyre te lire ortaket e shoqerise:

MARIGLIANO SALVATORE lindur ne NAPOLI ne ITALI me 30/06/1988 me numer karte identiteti CA66432BH leshuar me 15/05/2018,

GIANLUCA PANAGIA lindur ne NAPOLI ne ITALI ne 23/01/1967 me numer karte identiteti CA59230ID leshuar me 22/02/2021,

ANTONIO CIONE lindur ne NAPOLI ne ITALI ne 21/06/1995 me numer karte identiteti CA83799AC leshuar me 26/01/2017

DEVIS UZUNI lindur ne BERAT, ne SHQIPERI me 18/09/1992 me numer karte identiteti J20918066L me 11/12/2019,

te cilet kane vendosur te hartohet statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar aktual, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

Neni 1 – Emertimi


1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **SOLOIL SERVICE ALBANIA** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

Neni 2 – Forma Ligjore

- 2.1 Shoqeria **SOLOIL SERVICE ALBANIA Sh.p.k** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlere ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi
- 2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Neni 3 – Selia

- 3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Rruga Deshmoret e 4 shkurtit, Ndertesa 68,Hyrja 10,Kati 4, Ap 15 ,Tirane,Shqiperi.
- 3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.



3.3 Mbledhja e Ortakeve, mund të vendose, transferoje dhe/ose të mbylle, si brenda edhe jashtë shtetit shqiptar, dege sekundare, fillale, seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

Neni 4 – Objekti

4.1 Shoqëria ka për objekt social çdo operacion tregtar legjitim i cili përfshin, pa kufizim, aktivitetet e listuara si më poshtë: Transportin, mbledhjen, trajtimin, përpunimin e mbetjeve jo të rrezikshme, vajrave, magazinimin, riciklimin dhe shkëmbimin e mbeturinave jo të rrezikshme, tregtimin e vajrave. Import-Eksport të vajit ushqimor, stacion transferimi mbetjesh jo të rrezikshme, transport të vajit të përdorur. Mbledhje nga të tretet në shtëpi, apartamente dhe fabrika. Shoqëria mund të përmbushë çdo operacion legjitim për tregtimin si dhe ndërmjetësimin dhe eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme lendeve të para dhe dytesore dhe mallrave të përfuturara nëpërmjet trajtimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme, çdo gjë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.2 Shoqëria mund të ofrojë shërbim konsulence për persona të përket grumbullimit, transportit, riciklimit, ruajtjes, rikuperimit, asgjësimit, shitjes së mbetjeve dhe/ose të lendeve të para dhe dytesore. Shoqëria mund të kryejë investime, ndërtime, të menaxhojë impiantet për prodhimin dhe shitjen e mallrave të prodhuar, dhe të riciklin dhe rikuperimin e mbetjeve ose lendeve të para dhe dytesore si dhe për partneritet aktivitetet industriale apo alenca strategjike të përbashkëta.

4.3 Shoqëria mund të kryejë studimet e tregut, rrjetet komerciale, të lidhë kontrata agjencie, të krijojë agjenci ose zyra përfaqësuese. Shoqëria mund të ofrojë gjithashtu shërbime konsulence, mjedisore, teknike dhe administrative dhe të kordinojë shërbime marketingu dhe promovionale për zgjidhjen e problemeve në fushat e mjedisit dhe të sigurisë në punë.

4.4 Shoqëria mund të kryejë çdo veprim tregtar që përfshinë: blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të vendosë hipoteka, aplikim për kredi dhe garanci financiare, personale dhe reale për paletë të treta. Shoqëria mund të menaxhojë, blejë, shesë ose japë me qira aktivitetet, si dhe të punësojë dhe të marrë pjesë në aktivitetet dhe të blejë aksione të shoqërive, enteve, korporatave të regjistruara dhe që do të regjistrohen me objekt të njëjtit ose të ngjashëm. Shoqëria mund të themelojë shoqëri shqiptare ose të huaja, si dhe të blejë aksione të shoqërive të tjera. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të favorshëm të lejuar nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektivave të saj.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

Neni 6 – Kapitali Social

6.1. Kapitali social është 10000 (dhjetë mijë) Leke dhe i përbërë nga 4 (KATER) kuota të barazvlefshme me 3000 (tremijë lek) të Antonio Cione, 3400 (tremijë e katerqind lek) të Marigliano Salvatore, 3000 (tremijë lek) të GianLuca Panagia, 600 (gjashtëqind lek) të Devis Uzuni .




- 6.2. Kapitali është plotësisht i regjistruar dhe i leshuar në mënyrën e mëposhtme:
- **MARIGLIANO SALVATORE** zoteron 34%, (tridhjetë e katër për qind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 3400 (tremijë e katërqind) lekë
 - **ANTONIO CIONE** zoteron 30%, (tridhjetë për qind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 3000 (tremijë) lekë
 - **GIANLUCA PANAGIA** zoteron 30%, (tridhjetë për qind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 3000 (tremijë) lekë
 - **DEVIS UZUNI** zoteron 6%, (gjashtë për qind) të kapitalit aksionar i vlefshëm me 1 (një) kuota, të cilat korrespondojnë me 600 (gjashtëqind) lekë

Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

Neni 8 – Administratorët

- 8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojnë veçmas ose bashkërisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.
- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u riemëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.
- 8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure të veçantë për një akt ose një sërë aktesh.
- 8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas një tarife të parashikuar në ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.
- 8.7 Me këtë Statut vendoset si Administrator i Shoqërisë:



- Z GIANLUCA PANAGIA ,lindur ne NAPOLI, me 23/01/1967, me numer karte identiteti CA59230ID.

Neni 9- Gjuha

- 9.1 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e Neneve të Shoqatës, versioni italian do të jetë i vetmi statut ligjërisht i detyrueshëm.
- 9.2 Statuti aprovohet ne cdo nen nga ortaket e vetem themelues te shoqerise "SOLOIL SERVICE ALBANIA"SHPK te cilet nënshkruajne me emrin dhe mbiemrin e tij të gjitha kopjet.

* * *


ORTAKET THEMELUES

MARIGLIANO SALVATORE

GIANLUCA PANAGIA

ANTONIO CIONE

DEVIS UZUNI



Handwritten signatures of the four founders: Gianluca Panagia, Marigliano Salvatore, Antonio Cione, and Devis Uzuni.